REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

K R Y E T A R I

Nr. 961 Prot., Maliq, më 22.02.2025

PROJEKT-VENDIM

"Për dhënie ndihme financiare të menjëhershme familjeve në nevojë"

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 *"Për vetqeverisjen vendore"* neni 29, ligjin nr. 45/2019 *"Për Mbrojtjen Civile"*, neni 30 gërma '**gj**' dhe neni 41 pika '**2**' , VKM-në nr. 329, datë 16.05.2012 *"Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore si dhe fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"*, Kreu III pika 1- Procedura e vlerësimit të dëmeve germa *"a"* dhe *"ë"*, për rastin e rënies së zjarrit në banesën e z. Besnik Hysolli, banues në fshatin Bregas (Koritë), Njësia Administrative Vreshtas;

i kërkoj Këshillit të Bashkisë Maliq:

1.Të miratojë një ndihmë financiare prej 696.000 lekë, për familjen e z. Besnik Hysolli , të cilit i'u dogj banesa më datën 08.02.2025 - ku vlera e plotë e dëmit të shkaktuar në banesë nga ana ndërtimore është *1,200,000.3* lekë *(vlera prej 50 % është **600,000.2** lekë)*. Vlera e dëmeve në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake është *96.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **696,000.5** lekë.

2. Pagesa do të bëhet nga Programi i Mbrojtjes Civile si më poshtë:

Gr.	Kap.	Kod.Prog.	Llog.Eko.	Vlera (000)
17	01	10910	604	696

3. Për zbatimin e vendimit ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.

4. Ky vendim hyn në fuqi mbas miratimit të bazueshmërisë ligjore nga institucioni i Prefektit Korçë.

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE KRIZAVE

Nr. 261 Prot

Maliq, më datë 22.02.2025

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Besnik Hysolli të cilit i është djegur banesa e tij.

Në datën 08.02.2025, ora 15:25 u dogj banesa e z. Besnik Hysolli, banues në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika1, gërma *"b"* Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 103, datë 17.02.2025, shkoi në banesë dhe përgatitii procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1,200.000.3* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **600,000.2** lekë*).Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *96.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **696,000.2** lekë. Mbështetur në preventivat sa më sipër i propozohet Këshillit të Bashkisë për dhënien e ndihmës financiare si më poshtë:

Ti jepet një ndihmë financiare z. Besnik Hysolli për dëmet nga ana ndërtimore në një shumë prej *600,000.2* lekë, dhe ne pajisje dhe orendi elektroshtëpiake në një shumë prej *96.000* lekë. Totali për t'u dëmshpërblyer është ***696,000.2*** lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 "*Për vetqeverisjen vendore"neni 29, ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012;*

Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi:	R. Mara		22. 2. 2025
	Ll. Kotmilloshi		22. 2. 2025
Përgjegjës sektori:	S. Belishta		22. 2. 2025

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr. 361 Prot

Maliq, më datë 22.02.2025

Relacion

Për përcaktimin e masës së ndihmës financiare të menjëhershme për familjen e z. Besnik Hysolli të cilit i është djegur banesa e tij.

Në datën 08.02.2025, ora 15:25, u dogj banesa e z. Besnik Hysolli, banues në fshatin Bregas, Njësia Administrative Vreshtas dhe si pasojë pati dëme nga ana ndërtimore, si dhe në pajisje dhe orendi elektro-shtëpiake. Bazuar në VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "*Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatëkeqësitë natyrore ose veprimtaria njerëzore*", sipas përcaktimit në Kreun III, pika 1, gërma *"b"* Komisioni i Konstatimit të Gjendjes bazuar në urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 103, datë 17. 02. 2025 shkoi në banesë dhe përgatiti procesverbalin e konstatimit të gjendjes. Bazuar në procesverbalin e mbajtur u hartuan edhe preventivat për dëmet e shkaktuara nga ana ndërtimore si dhe në pajisje dhe orendi elektroshtëpiake. Në bazë të preventivave dëmi në anën ndërtimore është në shumën *1,200,000,3* lekë (*50% e vlerës e barabartë me **600,000.2** lekë*). Vlera e dëmit në orendi elektroshtëpiake është *96.000* lekë. Vlera totale për t'u dëmshpërblyer është **696,000.2** lekë.

Mbështetur në preventivat e mësipërme dhe aftësitë financiare të Autoritetit Vendor i kërkojmë Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit të akordojë ndihmën financiare të menjëhershme për familjen e z. Besnik Hysolli të cilit i'u dogj banesa si pasojë e rënies së zjarrit dhe jeton në kushte të vështira ekonomike. Lidhur me situatën, mbulimi i dëmit të shkaktuar për familjen e z. Besnik Hysolli të bëhet nga fondi i Mbrojtjes Civile në Bashki në vlerën **696,000.2** lekë.

Propozimi i mësipërm është bërë duke u bazuar në ligjin nr.139/2015 *"Për vetqeverisjen vendore", neni 29,ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", neni 30 dhe 41 dhe VKM-në nr.329, datë 16.05.2012:*

- Vendimit nr. 130, datë 26.12.2024 *"Për miratimin e Buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2025".*

	Emër /Mbiemër	Nënshkrimi	Data
Konceptoi :	R. Mara		22. 2. 2025
	I.I. Kotmilloshi		22. 2. 2025
Përgjegjës Sektori :	S. Belishta		22. 2. 2025
Përgjegjës Sektori Juridik	J. Thomo		22. 2. 2025
Drejtore e Financës dhe Buxhetit :	A. Muka		22. 2. 2025

KRYETARI I BASHKISE
Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr.361 Prot. Maliq, më 18.02.2025

Procesverbal-Konstatimi

I mbajtur në datën 18.02.2025 në banesën e z. Besnik Hysolli, banues në fshatin Bregas (Koritë), Nj. Administrative Vreshtas, në zbatim të Urdhërit të Kryetarit nr. 103, datë 17.02.2025, komisioni i konstatimit të gjendjes konstatoi se në banesë pati dëme të konsiderueshme nga ana materiale si dhe në orendi dhe pajisje elektro-shtëpiake si më poshtë:

a-DËME NGA ANA NDËRTIMORE

1.Punime çatie

2.Punime dyer /dritare

3.Punime suvatimi

4.Punime elektrike

5.Punime bojatisje

b-DËME NË ORENDI DHE PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE

- Divane, copë 1 ;
- Karrige, cope 2;
- Sobë me gaz, copë 1;
-Krevat tek + dyshek, cope 1
-Taviline buke, cope 1
-Komodine, cope 1

Komisioni

1. Stiljan Belishta

*2.*Qezar Bezati

3. Agim Trebicka

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

SEKTORI I PLANIFIKIM -PËRBALLIMIT TË EMERGJENCAVE CIVILE DHE KRIZAVE

Nr 861 Prot

Maliq, më 20.02.2025

Preventiv

Preventivi i dëmit në orendi dhe pajisje të shkaktuara nga rënia e zjarrit në banesën e z. Besnik Hysolli, banues në fshatin Bregas (Koritë), Nj. Administrative Vreshtas të cilit i'u dogj banesa më datën 08.02.2025

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi/Njësi (lekë)	Shuma
1	Divane	Copë	1	25.000	25.000
2	Sobë me gaz	Copë	1	20.000	20.000
3	Karrige të zakonshme	Copë	2	4.000	8.000
4	Tavolinë Buke	Copë	1	20.000	20.000
5	Krevat tek + dyshek,	Copë	1	15.000	15.000
6	Komodine	Copë	1	8000	8.000
Totali					**96,000**

Çmimet e orendive dhe pajisjeve i janë referuar të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për vitin 2016 dhe 2023.

Komisioni:

1-Ilirjan Islamaj

2-Marjana Zhuli

3-Rodjan Mara

KRYETARI BASHKISE

Gëzim TOPÇIU

Adresa: Bulevardi "Rinia", Maliq, Korçë

Tel. & Fax. 0861 2 2026

Maliq Dt. 20.02.2025

Objekti: Rikonstruksioni i Shtepisë së Djegur
Pronari: Besnik Hysolli
Vëndndodhja: Fshati Bregas Njesia Administrative Vreshtas
Bashkia Maliq

Nr.	Nr. AN	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSI	SASI	ÇMIMI	VLERA
		VI. PUNIME ÇATIE				
1	2.64/1	Mur me tulla te plota ne lartesi deri 3m, llaç të përzier M 15 (oxhak+brez)	m3	2	20021.00	40,042.0
2	2.292	Trare tavani te sharuar +dysheme kati perdhe	m2	130	473.30	61,529.0
3	2.219	Çati vendi e zakonshme mbuluar me tjeguila marseleze	m2	90	3932.63	353,936.7
4	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingato 33 cm	ml	30	1195.97	35,879.1
5	2.209	Ulluk vertikal llamarine Φ 100	ml	6	942.01	5,652.1
6	2.203	Veshje kornize me llamarine	m2	2.5	1882.60	4,706.5
		PUNIME SUVATIMI				0.0
1	2.295	Tavan rrjete teli + suva	m2	70	3023.16	211,621.2
2	2.310	Suva brenda mur tulle h~4m me krah llaç të përzier M 25	m2	200	1124.2	224,840.0
		PUNIME DYER DHE DRITARE				0.0
1	3.395	Dritare duralumini plastik	m2	6.5	11343.48	73,732.6
2	2.388/1	FV dyer të brendshme tamburate të rimesuara	m2	10	13985.76	139,857.6
		PUNIME BOJATISJE				0.0
1	2.399	Sherbetosje me gelqere	m2	250	85.28	21,320.0
		PUNIME ELEKTRIKE				0.0
1	2.490/b	F.V. Kasete plastike KE me 6 modular (vende)	copë	1	1220.92	1,220.9
2	2.487	F.V.Kuti shperndarese me kapak me vida PT-2	copë	4	179.7	718.8
3	2.480/2	F,V. Tubo freksibel i bute Ø 20 ÷ 21 mm	ml	30	177.52	5,325.6
4	2.482/1	F.V. Percjelles petashuk PVC Ø 2 x 1.5mm2	ml	10	121.86	1,218.6
5	2.481/1	F.V. Percjelles bakri PVC 1.5mm	ml	60	38.99	2,339.4
6	2.481/2	F.V. Percjelles bakri PVC 2.5mm	ml	60	55.8	3,348.0
7	2.486	F.V. Portollampa normale 10A	copë	5	298.44	1,492.2
8	2.487/c	F.V. Kuti suport pllaket 2 modular	copë	5	321.83	1,609.2
9	2.485/1	F.V. Çelës ndriçimi 1P 10A 250V	copë	5	593.25	2,966.3
10	2.485/g	F.V. Priza shuko universale	copë	6	649.8	3,898.8
11	2.490/1a	F.V. Automat 2P, 220V, 10A	copë	1	1235.12	1,235.1
12	2.490/1b	F.V. Automat 2P, 220V, 16A	copë	1	1510.70	1,510.7
		SHUMA				**1,200,000.3**
		Mara e shtveres se demit prej 50%				600,000.2

Preventivi është hartuar mbështetur në Manualet e vitit 2024

Preventivoi: Ing.Marjana ZHULI

KOMISIONI I VLERESIMIT

Ilirjan Islamaj Marjana Zhuli Rodjan Mara

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË MALIQ
Gëzim TOPÇIU